

RAPORT TEKNIK

Objekti: "Ndërtim ure me konstruksion metalik (mbi bazamente ekzistuese), fshati Luz, Nj.A.Fushë Krujë, Krujë"

**Autor i Projektit
"ERALD - G" shpk**



VITI - 2021

I.TË PËRGJITHSHME.

I.1.Shtrirja gjeografike.

Bashkia Krujë shtrihet rreth 20 km në veri të qytetit Tiranë dhe përveç Njesisë Vendore Krujë ka në përbërje të saj dhe 5 Njësi Administrative, Fushë Krujë, Thumanë, Nikël, Bubq, Cudhi. Thuajse të gjitha Njësitë Administrative komunikojnë me njëra tjetrën dhe lidhen me qytetin Fushë Krujë, si qendër gjeografike e saj nëpërmjet akseve kombëtare kryesore që kryqëzohen në qytetet Fushë Krujë. Veç këtyre rrugëve komunikuese, ka dhe rrugë dytësore apo të treta që lidhin këto Njësi. Njësia Administrative Fushë Krujë shtrihet në anën qendrore të rrethit Krujë dhe kufizohet me Njësinë Vendore Krujë në lindje të saj, me Njësinë Administrative Bubq në perendim, ndërsa me Njësinë Administrative Thumanë në veri.

Komunikimi brenda fshatrave të Njesisë Administrative Fushë Krujë veç rrugëve të sipërcituara bëhej nëpërmjet urës me kavo metalike (Urë e varur, tip Pasarelë), e cila lidhte në mënyrë shumë të shkurtër banorët e fshatrave Luz i Poshtëm e Hasan me fshatin Luz i Sipërm, duke kursyes shumë kilometra dhe kohë, nëse do të zgjidhnin alternativa të tjera.

I.2.Klima.

Në nënzonën mesdhetare jugore ndryshimi ditor i temperaturës shkon nga një minimum rreth agimit, në një maksimum nga 1 deri 3 orë mbasi dielli ka aritur në zenith, mbas të cilës ka një rënje të vazhdueshme gjatë natës deri në agim.

Temperatura mesatare ditore ëshë mesatarja e temperaturës maksimale dhe minimale dhe normalisht është brenda kufirit të mesatares të vertetë që regjistrohet në mënyrë të vazhdueshme.

Temperatura është matur në gradë Celsius (°C). Nga vrojtimit e deritanishme rezulton se maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është 39.5 gradë. Në Shqipëri ne shtresën e ajrit që është 2m larg sipërfaqes së tokës konstatohet një amplitude e lartë termike prej 68.2 grade, kjo është një vleftë e ndjeshme por gjithnjë karakterizuese për vendet mesdhetare, me një relief fushor siç është Fush-Kruja. Temperatura mesatare vjetore në Fushë-krujë është 15.3°C. Temperatura mesatare e janarit 5.8°C, e korrikut 26.6°C, temperatura absolute më e ulët në Fushë-Krujë është -13°C, më e larta absolute 38.1°C. Reshjet mesatare vjetore 1618 mm për Fushë-Krujën.Kjo zonë karakterizohet nga diferenca të mëdha intesitetesh reshjesh.

I.3.Popullësia.

RAPORT TEKNIK

“Ndërtim ure me konstruksion metalik (mbi bazamente ekzistuese), fshati Luz, Nj.A.Fushë Krujë, Krujë”

Të gjitha të dhënat mbi popullsinë e Rajonit u dhanë nga Bashkia Krujë. Popullsia e Njësisë Administrative Fushë-Krujë deri në vitin 2018 nga të dhënat e Bashkisë është rreth 27 000 banorë.

Popullësitë respektive të fshatrave Luz i Poshtëm, Luz i Sipërm e Hasan (Nj.A.Fushë Krujë) janë 1000 banorë, 1100 banorë dhe 900 banorë, popullësi e cila lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ura me konstruksion metalik mbi lumin Zezë.

I.4.Ekonomia.

Fushë-Kruja renditet në qendrat me një zhvillim të mirë ekonomik, tregtar e bujqësor të vendit. Jo vetëm qyteti i F-Krujës, por i gjithë rrethi në tërësi ka luajtur historikisht një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të krejt vendit.

Në këtë zonë janë të mundshme për t'u zhvilluar të gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithatë midis tyre vlen të veçohen sektorë të tillë si industria e çimentos, e mobilerisë, ekonomia bujqësore.

II.URA ME KONSTRUKSION METALIK QË LIDH FSHATIN BILAJ ME FSHATRAZ LUZ E DERVEN.

II.1.Vendodhja/ pozita gjeografike/rindërtimi.

Ura me kavo metalike (tip Pasarelë) që lidh fshatin Luz I Sipërm me fshatrat Luz I Poshtëm e Hasan ka qenë ndërtuar rreth vitit 2003 nga ish bashkia Fushë Krujë, në lumin Zezë, në dalje të kufirin mes fshati Luz i Poshtëm e Hasan e fshatit Luz I Sipërm të bashkisë Krujë. Kjo urë këmbësore lidhte në mënyrë të drejtpërdrejtë rreth 3000 banorë.

Si pasojë e reshjeve të mëdha të viteve të fundit por edhe e amortizimit ndër vite(duke patur parasysh strukturën e sipërme të saj me element druri), si pasojë e prurjeve të mëdha e rreshjeve që cituam më sipër, kjo urë u dëmtua pjesërisht.

Nisur nga kërkesat e banorëve të fshatrave të mësipërm, si dhe pas verifikimit në vend të situatës nga grupet e konstatimit të dëmeve dhe Emergjencave Civile, u konkludua se kjo urë ishte drejtë shkatërrimit total, e për këtë qëllim, u propozua që të prishej pasi prania e saj në këtë gjendje përbënte rrezik për banorët.

Ndodhur në këto kushte mjaft emergjente, ku akoma fshatrat e mësipërm janë të izoluar, kërkohet domosdoshmërisht rindërtimi i kësaj ure, duke ruajtur strukturën mbajtëse ekzistuese dhe duke prishur mbistrukturëe e drurit e kavove dhe duke ndërtuar mbistrukturë të re me konstruksion metalik.

Ura e propozuar për ndërtim do ketë një gjatësi totale rreth 50ml, ku pjesa kryesore mes dy pilave ekzistuese do të jetë me konstruksion metalik (pas rritjes së lartësisë së pilave për efekt mospërmbytjeje) me element metalik mbajtës trarë “IPE”, ndërsa dy pjesët tjera me elementë më të lehtësuar.

Gjithashtu në dy anët e urës, kryesisht në pjesën e Luzit të Sipërm, do të ndërtohet një trase rruge nga strukturat e rrugëve rurale të bashkisë.

RAPORT TEKNIK

“Ndërtim ure me konstruksion metalik (mbi bazamente ekzistuese), fshati Luz, Nj.A.Fushë Krujë, Krujë”

II.2.Pamje orthofoto e urës.



II.3.Fotografi të urës së dëmtuar.



RAPORT TEKNIK

“Ndërtim ure me konstruksion metalik (mbi bazamente ekzistuese), fshati Luz, Nj.A.Fushë Krujë, Krujë”



Per:

“ERALD-G” Sh.p.k.

Ing. Gezim ISLAMI
ADMINISTRATOR